

Annex

13

PERGATITJA E MASTER PLANIT TE PARKUT TE LIQENIT DHE 5 PROJEKTE PILOT PER 5 SITE, NE KUADRIN E REHABILITIMIT TE PARKUT TE LIQENIT

25.09.2015

PERGATITJA E MASTER PLANIT TE PARKUT TE LIQENIT DHE 5 PROJEKTE PILOT PER 5 SITE, NE KUADRIN E REHABILITIMIT TE PARKUT TE LIQENIT

PROJEKTI PILOT 4 - KENDI I LOJRAVE PER FEMIJE

RELACION ARKITEKTONIK

BOLLES + WILSON

ATELIER4

Masterplani i Parkut te Liqenit te Tiranes, **PROJEKTI PILOT 4 - KENDI I LOJRAVE PER FEMIJE**

PERGATITJA E MASTER PLANIT TE PARKUT TE LIQENIT DHE 5 PROJEKTE PILOT PER 5 SITE, NE KUADRIN E REHABILITIMIT TE PARKUT TE LIQENIT

HYRJE

Ne Maj te 2015, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) kontrakttoi si Konsulent Bashkimin e Operatoreve Atelier 4 dhe Bolles + Wilson te udheheq marreveshjen : " Pergatitjen e Masterplanit te Parkut te Liqenit dhe 5 Projekte Pilot per 5 Site, ne Kuadrin e Rehabilitimit te Parkut te Liqenit"(Studim). Produkti i Masterplanit dhe ky raport mbeshitetes propozon nje vizion dhe nje plan kuader mbi arkitekturen te cilat sjellin se bashku elementet ekzistues dhe te propozuar te aktiviteve ne nje projekt Masterplani.

Nje element kyc ne procesin e dizenjimit ishte kerkesa per te angazhuar komunitetin vendas, grupet e perdorimit, autoritetet lokale dhe grupet e interesit ne menyre qe te gjitha pikepamjet dhe aspiratat e tyre te merreshin plotesisht ne konsiderate. Ne elementet final te Masterplanit jane dhene prioritetet e zhvillimit te ndara ne faza si dhe 5 Projektet Pilot per 5 Site duke i dhene mundesine Bashkise se Tiranes te hartojne nje program financimi per secilen faze.

Duke marre parasysh permasat dhe elementet natyror, Parku i madh i liqenit ka potencial tu ofroje individeve te ndryshem aktivite mjaft te ndryshme: nje vend takimi, nje vend per aktivite sportive dhe rekreative, nje vend per tu terhequr nga zhurma e qytetit ku individi perballet me natyren.

MASTER PLANI

Masterplani eshte nje projekt qe paraqet nje vizion per zhvillimin e nje zone te caktuar ne te ardhmen duke marre ne konsiderate elementet e meposhtem:

- statistikat e perdoruesve dhe jo perdoruesve
- situaten ekzistuese te zones, funksionet dhe perdorimin e tyre
- elementet ambientale, flores dhe faunes qe kjo zone perfshin
- komuniteti dhe zonat kufizuese
- struktura e menaxhimit
- zonat per te identifikuar trendin aktual te perdorimit
- levizjet demografike aktuale dhe te parashikuara
- objektivat dhe kerkesat e grupeve te interesit

Masterplani analizon elementet ekzistues te zones me qellimin per te integruar mundesi te

reja per te rritur dhe kompletuar funksionet dhe sherbimet per komunitetin dhe do te perdoret Masterplani i Parkut te Liqenit te Tiranes, si nje guide per te treguar dhe informuar per fazat e zhvillimit gjate viteve dhe te paraqese nje plan kuader per:

- Strategjine per te rritur mundesite e rekreacionit te pergjithshem per perdoruesit e parkut
- Modifikimin dhe shtimin e fushave sportive duke rritur dhe racionalizuar perdorimin e tyre me rritjen e kerkeses
- Permireshime te ndjeshme ne rrjetin rrugor dhe kembesor
- Strategjine e menaxhimit te hapësirave natyrore te lidhura me aktivitetet e propozuara

Eshte e rendesishme qe te theksohet se qellimi i Masterplanit eshte te jape nje structure zhvillimore te Parkut te Liqenit, ne nje periudhe te gjate kohore ne menyre qe te evitohen zhvillime te rastesishme, te maksimizohet perdorimi nga komuniteti dhe qendrushmeria e zhvillimit. Masterplani duhet te jete nen monitorim gjate zhvillimit te tij ne kohe per te siguruar qe perfitimet te permbushin kerkesat e komunitetit. Per zhvillimin e koncept-ideve jane kosideruar si themelore elementet me poshte:

- mbeshtetja e zhvillimit te infrastruktures me projekte apo me elemente te mobilimit urban per te siguruar nje rritje te kapacitetit te perdorimit
- siguruar perfshirjen e komunitetit nepermjet konsultimeve
- ruajtur karakterin dhe komoditetin ekzistues te zones
- mbrojtur dhe ruajtur vlerat ekologjike te zones dhe cilesine e ujerave nentokesore
- maksimizimin e mundesive te aksesit per aktivite sportive, sherbimeve rekreative
- inkurajuar lehtesimin e qetesise publike

Cfare eshte kendi i lojrave?

Sipas profesionisteve aftesite sociale qe femijet zhvillojne ne kendin e lojrave shpesh jane aftesi qe ata i mbartin gjate gjithë jetes se tyre, edhe ne jeten e tyre si te rritur. Shume studime tregojne qe kendet e lojrave jane nje nga ambientet me te rendesishme ne aktivitetin e femijeve jashte shtepise. Pjesa me e madhe e lojrave jane thelbesore ne nje zhvillim te shendetshem, te lire dhe spontan te femijeve - dhe ky ndodh vetem ne kendin e lojrave. Ekziston nje konsensus i pergjithshem qe aktiviteti fizik i femijeve, ul riskun per probleme psikologjike te femijet, dhe ushqen vete-besimin. Pra kendet e lojrave sigurojne nje mundesi ideale per femijet, per te permireshuar aftesite e tyre fizike, duke mesuar te lekundet, balancen dhe ngjitjen. Zhvillime personale mund te zhvillohen nepermjet permireshimit te aftesive si lojen, komunikimin dhe bashkepunimin me femije te tjere dhe te rritur ne kendin e lojrave. Per femijet, koha e vajtjes ne kendin e lojrave , eshte koha me e bukur e dites, sepse ajo eshte si nje shkarkim te presionit te mesimeve gjate dites. Ndaj duke marre ne konsiderate qe qyteti i Tiranes ka nje mungese te larte te ketyre

hapesirave mjaft te rendesishme per femije, u pa e arsyeshme qe nje nga projektet pilot te Master Planit te parkut te liqenit, te ishte kendi i lojrave per femije.

Pershkrimi i Zones

Zona ne te cilen propozohet te vendoset kendi i lojrave ndodhet ne pjesen Veri-Perendimore te parkut te Liqenit, nje hapsire kjo paralele me "Shetitoren e Besimit", e cila eshte jashte territorit te nderhyrjes se Master Planit.

Eshte nje zone e pyllezuar, relativisht me drure te rinj dhe ka nje siperfaqje afersisht 4000 m².

Ne Master plan eshte perzgjedhur ky terren per te realizuar Kendin e Lojrave, sepse eshte nje zone qe ndodhet afer hyrjes se parkut dhe eshte e lidhur drejtperdrejte me qytetin, pikerisht me sheshin "Nene Tereza". Gjithashtu kjo zone eshte e pershtatshme per nje aktivitet te tille, pasi kjo eshte zona me frekuentim me te larte ne park.

ANALIZA E SITUATES EKZISTUESE TE ZONES

Zona paraqitet me nje pjerresi qe vjen duke u rritur nga perendimi ne lindje dhe duke zbritur nga veriu ne jug, ne drejtim te liqenit artificial. Pjerresia e terrenit mundeson levizjen e ujrave te shiut ne drejtim te liqenit.

Zona kufizohet nga rrugica kembesoresh, te cilat nga mos mirembajtja kane degraduar me kalimin e kohes, nga ana vizuale eshte e konturuar me peme relativisht te larta. Zona gjithashtu ka nje bimesi pjesisht te dendur. Ne kete zone dominojne pemet e : eukaliptit, pishe, plep, mimoze, kumbull e kuqe, etj.

KONCEPTI I NDERHYRJES - KENDI I LOJRAVE PER FEMIJE

Zona qendrore e parkut eshte nje zone ndermjet shetitores se "Besimit" dhe bregut te liqenit. Per te rritur fokusin ne kete zone qendrore, jane propozuar ne Masterplanin e parkut te liqenit nje sere funksionesh te perziera, ku nder te tjera jane propozuar:

- 1- Kendi i Lojrave per femije
- 2- Treni per femije

Duke pasur nje kontakt te vazhdueshem me dhe institucioneve vendore dhe diskutimeve te shpeshta per vizionin e ketij studimi dhe 5 projekteve pilot, nje numer i madh propozimesh per nderhyrje ne zone jane analizuar per perzgjedhjen e Projekteve Pilot per 5 Site. Perzgjedhja e zones per Projektin Pilot 4, kendin e lojrave per femije, ka marre ne konsiderate elementet e meposhtem:

- afersia qe duhet te kete zona me qendren e qytetit dhe kryesisht me sheshin "Nene Tereza" duke krijuar akses te drejtperdrejte me qendren e qytetit dhe zonat e tjera rekreative te qytetit
- vendodhja e zones ne piken me te frekuentuar te parkut te liqenit
- Akses i drejtperdrejte nga cdo grupmoshe femijesh
- Afersia e zones me rrjetin rrugor ne rast emergjence dhe ndihme te shpejte.

Kendi i lojrave per femije eshte propozuar te jete nje shirit paralel me shetitoren e Besimit, i cili rrethohet nga shinat e trenit - miniatyre per femije.

Terreni, bimesia (pemet ekzistuese) dhe diversiteti i moshave qe mund te frekuentojne kendin e lojrave kane qene pikat themelore mbi te cilat ka nisur te projektohet dhe konceptohet kendi i lojrave. Eshte menduar te jete nje hapësire pothuaj per te gjitha moshat duke shfrytezuar ne maksimum pjerresine e terrenit.

Zona e kendit te Lojrave sipas Master Planit eshte paralel dhe ka lidhje te drejperdrejte me nje hapësire tjeter e quajtur Grand Kafe, nje hapësire kjo e rezervuar per prinderit, te cilet duke pire nje kafe ose duke lexuar nje gazete kane ne kontroll femijet e tyre. Ne majen e kodres tarraca e Grand Kafes eshte e pajisur me kioska akullore, gazetash, platforme vallezimi, pike informacioni ne lidhje me parkun si dhe nje zone per ndihmen e shpejte. Zona e perzgjedhur per kendin e lojrave, ne vazhdimesi te propozimeve ne Master Plan lidhet me nje shetitore e cila zgjatet drejt liqenit, ku eshte vendosur klubi i vozitjes dhe nje pishine publike lundruese brenda ne liqen, te cilat mbulohen nga nje platforme dritash e quajtur "Tufa e Xixellonjave"

Kendi i lojrave eshte menduar te jete si nje platforme lojrash dhe aktiviteteesh per te gjitha grupmoshat e femijeve, nga mosha 1 vjec deri ne moshen 14 vjec, pse jo edhe me te rritur. Ne kete platforme aktiviteteesh, lojrat e perzgjedhura per cdo moshe percaktojne edhe zonat e grupmoshave te ndryshme te kesaj platforme. Pra nje platforme e *vetme* eshte e ndare ne disa zona sipas grupmoshave te ndryshme te vendosura ne kuota te ndryshme, te ndara nga njera tjetra, me shkalle, rampa dhe nepermjet materialeve. Cdo zone duhet te jete e pajisur me tabela druri qe tregojne grupmoshen se ciles kjo zone i perket (shembull reference: Playground at Promenade du Paillon ne Nise te Frances. Kjo strategji projektimi perdoret per disa arsye:

- per tu ardhur ne ndihme prinderve qe mund te kene femije te moshave te ndryshme
- socializimi ndermjet grupmoshave

Kendi i lojrave eshte konceptuar te jete nje teater, nje skene te vertete ku vete femijet jane aktoret. Nuk ka skenare dhe regjizore. Performanca duhet "LOJE", dhe perberesit percaktohen nga imagjinata e femijeve. Kendi i lojrave eshte konceptuar si nje aventure, nje udhetim ne kohe, nje udhetim drejt femijerise.

Eshte konceptuar me nje shetitore e cila rritet dhe zvogelohet ne kuote duke ndjekur pjerresine e kodres. Nga kjo shetitore ushqehen te gjitha zonat e ndara per femije sipas grupmoshave te ndryshme. Pjerresia e terrenit ka ndikuar ne zonimin e kesaj hapësire sipas grupmoshave te ndryshme. Kendi i lojrave eshte i ndare ne **8 Zona** per grupmosha te ndryshme si me poshte:

1-Zona per femije prej 9 vjec e siper, propozohet te jete ne hyrje te kendit te lojrave, e pajisur me nje amfiteater (duke shfrytezuar pjerresine e terrenit) ku perballe tij, jane vendosur mbi nje platforme zhavori te imet 4 fusha ping-pongu per te gjitha grupmoshat. Nderkohe qe femijet jane duke luajtur ping-pong, prinderit ulen ne amfiteater dhe shohin "ndeshjet" ndermjet femijeve. Gjithashtu kjo zone, e konceptuar ndryshe edhe si hyrja e kendit te lojrave, shfrytezon nje nga pemet ekzistuese te parkut si "Pema e Deshirave", ku femijet, pse jo dhe te rriturit varin ne te deshirat e tyre, te shkruara ne leter. Fushat e ping-pongut jane te vendosura mbi dysheme gome, per te shmangur cdo aksident te mundshem. Per te krijuar nje atmosfere sa me te kendshme dhe magjike ne kete zone propozohen te mbillen edhe 4 peme qershie, te cilat ne pranvere do ti japin nje tjetër ndjesi hyrjes se kendit te lojrave.

2- Zona per femije nga inosha 1- 3 vjec, nje zone kjo e menduar per femije te mitur te cilet duhet te jene nen kujdesin e vazhdueshem te prinderve. Kjo zone eshte menduar te jete ne formen e nje grope rere te imet, e pajisur rreth e rrotull me stola druri dhe betoni per prinderit.

Stolat e betonit jane dizenuar dhe vendosur me kujdes, duke shfrytezuar disnivelein natyral te terrenit. Zona eshte e pajisur gjithashtu me elemente lojrash druri per femije te kesaj grupmoshe te cilat ndihmojne ne rritjen dhe zhvillimin e aftesive fizike dhe shqisore te femijeve te kesaj grupmoshe.

3 - Zona per femije nga mosha 3-6 vjec, eshte nje zone e cila eshte ne vazhdimesi te 2 zonave te permendura me siper. Ajo eshte e pajisur me lojra druri per femije te kesaj moshe. Per te patur nje diversitet dhe dinamike ne materiale, kjo zone eshte menduar te jete me ashkla druri, ndersa ne zonat ku jane instaluar lojrat, gjithmone eshte menduar te vendoset gome (*EPDM RUBBER GRANULES*) per te shmangur cdo aksident te mundshem.

4 - Zona per femije nga mosha 3-12 vjec, eshte menduar te jete nje zone paralel me tre zonat e permendura me siper, me nje diference kuote prej afersisht 135 cm dhe eshte zona me dinamike e te gjithë kendit te lojrave, duke ofruar diversitet ne materiale, lojra dhe aktivitete. Kjo zone eshte menduar te jete e gjitha nje platforme gome, e cila vesh ne menyre natyrale terrenin e pjerret, dhe ne zona te ndryshme cahet, per te formuar kodrina me bar natyral. Kjo zone eshte e pajisur edhe me nje mur per ngjitjen e femijeve te apasionuar pas alpinizmit.

Muri prej betoni, per te shmangur cdo aksident te mundshem, eshte menduar te jete ne forme harku duke rritur gradualisht lartesine. Ne anen e kundert te ngjitjes muri eshte menduar te zbrese ne nivelein e tokes ne formen e nje kodre me bar, me nje pjerresi te bute. Keto dy elemente i japin murit jo vetem vlera funksionale, por e kthejne ate ne nje skulpture mes gjelberimit.

5 - Zona per femije nga mosha 12 vjec, eshte menduar te jete si nje platforme gome ne forme eliptike, ku ne mes eshte vendosur "Pema e Basketbollit". Ky element eshte nje instalacion, ku jane shkrire me njeri tjetrin elementet e pemes me koshin dhe tabelen e basketbollit. Ashtu si deget e pemes qe jane ne lartesi te ndryshme, edhe koshat me tabelen e basketbollit jane "degezuar" ne lartesi te ndryshme ne menyre qe ky element te perdoret njekohesisht nga disa femije te moshave dhe larteseve te ndryshme. Zona eshte vendosur me kujdes ne nje zone qe nuk ka peme me perjashtim te dy pemeve, te cilat propozohet te spostohen.

6 - Zona per femije 3 - 12 vjec, ka si element kryesor murin "Shetitesl" (Wanderwall) i cili eshte konceptuar si nje element me funksion zbavites dhe argetues, duke patur vlera skulpturore sherben gjithashtu si nje vend takimi ndermjet femijeve. Ky element eshte menduar te jete 4 m i larte dhe me nje platforme gome te bute, 15 cm nga niveli natyral i tokes.

7- Zona per femije 6-12 vjec, eshte nje zone me nje instalacion druresh masiv, qe sherben per te rritur aftesite fizike te femijeve te kesaj grupmoshe. Instalacioni eshte vendosur ne terren natyral i gjelberuar.

8- Zona per femije nga mosha 14 vjec, eshte nje platforme betoni e lemuar, ku femijet e kesaj grupmoshe luajne me patina dhe "skateboard".

Te gjitha zonat e permendura me siper jane vendosur ne menyre te tille qe asnje nga pemet ekzistuese ne park te mos priten, me perjashtim te 3 pemeve te cilat do te spostohen dhe do te mbillen ne nje vend me te pershtatshem.

Platforma e kendit te lojrave eshte e rrethuar nga shinat e trenit miniature, te cilat jane vendosur ne terrenin natural te parkut.

Modulet e lojrave te propozuara jane te nje cilesie te larte, te ndertuara me dru masiv te stazhionuar dhe te trajtuara me pare me llak kundra lageshtires, me aksesore plastik. Lojrat e propozuara luajne jo vetem rol ne zhvillimin e aftesive fizike te femijeve, por edhe ne zhvillimin e aftesive ndijore.